



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 194, Datë 12.08.2025

MBI

**DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN NËPËRMJET
VENDOSJES SË BARRËS SIGURUESE TË ASETVE FIKSE TË SHOQËRISË “SPV
BLUE 2” SH.P.K.**

Në mbështetje të neneve 16, 20, gërma “a”, dhe 44 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; neneve 4, gërmat “a” dhe “b”, 6, 7 dhe 8 të Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.07.2016; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 12.08.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2199/1 prot., datë 07.08.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet marrëveshjes siguruese) të aseteve fikse të saj.”,

Konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënie e autorizimit për shoqërinë “SPV BLUE 2” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për Marrjen e Autorizimit

- Shoqëria me shkresën nr. 2199 prot., datë 29.07.2025, ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) me qëllim garantimin e shlyerjes së marrëveshjes së kredisë sindikale në favor të “Banka e Tiranës” sh.a., “Banka OTP Albania” sh.a., “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a. dhe “Union Bank” sh.a., ku Agjent i Kredisë dhe i Kolateralit është zgjedhur “Banka e Tiranës” sh.a..

2. Shqyrtimi i Kërkesës dhe Dokumentacionit të Paraqitur

- Shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k. është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 296, datë 30.12.2024, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaiik “Blue 2”.
- Nga shqyrtimi i aplikimit të përcjellë nga shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k., rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin/informacionin e kërkuar në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 4, 6, 7 dhe 8, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, si vijon:

3. Plotësimi i Kërkesës sipas nenit 7:

- **Pika 1** - Janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi kërkesën për transferim, ndër të tjera si më poshtë vijon:
 - **Gërma “a”** – Është depozituar Ekstrakti historik i shoqërisë, i vlefshëm brenda afatit ligjor;
 - **Gërma “b”** – Është plotësuar informacioni mbi veprimtarinë e licencuar;
 - **Gërma “c”** – Është plotësuar informacioni mbi gjendjen financiare të kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efekti i pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve;
 - **Gërma “d”** - Është bërë një përshkrim i kandidatit;
 - **Gërma “e” “f” dhe “g”** – Arsytet e kërkesës, efektet në aktivitetin e licencuar dhe furnizimin e klientëve;
 - **Gërma “h”** – Janë depozituar Marrëveshjet përkatëse;
 - “Kontratë Kredie” nr. 4338 rep., nr. 1877 kol., datë 30.05.2025, nënshkruar nga palët;
 - Marrëveshjen Siguruese (*marrëveshje barrë siguruese mbi asetet*) me nr. 4343 rep., nr. 1882 kol., datë 30.05.2025 të nënshkruar nga palët.
 - **Gërma “i”** – Deklarata e kredithënësit për garantimin e vazhdimësisë së aktivitetit;
 - **Gërma “j”** – Deklarata dhe vërtetimi për mungesë transferimesh të mëparshme mbi asetet fikse.
- **Pika 3** – Është plotësuar informacioni i kërkuar në këtë pikë që lidhet me detyrimet me të cilat ngarkohet subjekti për shkak të marrëveshjes së koncesionit në pjesët që transferojnë tek përfituesi *përfshirë edhe informimin e Autoriteti Shtetëror, në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve.*
- **Pika 4** – Kërkesa për aplikim është nënshkruar nga administratori i shoqërisë, ndërsa dokumentet e tjera shoqëruese të këtij aplikimi janë nënshkruar nga administratori dhe/ose personat e autorizuar sipas rastit.
- **Pika 6** – Shoqëria ka bërë me dije se kërkon të mos jenë të hapura për publikim, për arsye konkurrence, Marrëveshja e Barrës Siguruese mbi asetet me nr. 4343 rep., nr. 1882 kol., datë 30.05.2025, nënshkruar midis shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. dhe huadhënësve, Marrëveshja e Kredisë Sindikale me nr. 4338 rep., nr. 1877 kol., datë 30.05.2025, lista e aseteve për të cilat kërkohet marrja e autorizimit nga ERE si dhe të dhënat ekonomike dhe financiare të shoqërisë. *Megjithatë, vlerësohet se, për arsye ligjore dhe në përputhje me parimin e transparencës së vendimmarrjes publike, disa nga këto elemente, si identiteti i kredithënësve dhe lista e aseteve objekt i barrës, janë thelbësore për përmbajtjen e aktit administrativ dhe nuk mund të përjashtohen nga publikimi. Për rrjedhojë, lista e aseteve, duke qenë pjesë përbërëse e vendimit të ERE-s, publikohet së bashku me vendimin përkatës, ndërsa për pjesën tjetër të dokumentacionit do të mbahet në konsideratë konfidencialiteti i tyre nga ana e ERE-s.*

4. Kushtet e Vendosura për Dhënien e Autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të shoqërisë (sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi), nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese, me qëllim garantimin e shlyerjes së marrëveshjes së kredisë sindikale në favor të “Banka e Tiranës” sh.a., “Banka OTP Albania” sh.a., “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a. dhe “Union Bank” sh.a., ku “Banka e Tiranës” sh.a. është Agjent i Kredisë dhe i Kolateralit, nuk e përjashton këtë të

fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

- Për shkak të natyrës që ka vendosja e një mjeti të tillë mbi asetet e shoqërisë për garantimin e detyrimit përkatës nga i licencuari, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë që të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi asetet e saj ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e autorizimit për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k., si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Banka e Tiranës” sh.a., “Banka OTP Albania” sh.a., “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a. dhe “Union Bank” sh.a., ku Agjent i Kredisë dhe i Kolateralit është zgjedhur “Banka e Tiranës” sh.a., që rrjedhin nga kontrata e kredisë nr. 4338 rep., nr. 1877 kol, datë 30.05.2025. (Lista e aseteve bashkëlidhur)
2. Dhënia e autorizimit sipas përcaktimeve të pikës 1 nuk e çliron shoqërinë “SPV BLUE 2” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
3. Shoqëria “SPV BLUE 2” sh.p.k. të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi asetet fikse të saj që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar, ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm, si dhe në rast të çdo ndryshimi në këtë marrëveshje, përfshirë transferimin te të tretët .
4. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se shoqëria dokumenton heqjen e hipotekës dhe barrës siguruese të radhës së parë të vendosur mbi asetet e saj.
5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë “SPV BLUE 2” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI